

Për vaksinimin kundër herpesit (Herpes zoster, Zoster) – me vaksinën e inaktivizuar me nënjësi (rikombinante)

Herpesi (Zoster) është një skuqje shumë e dhimbshme dhe e kufizuar me zona, e cila shkaktohet nga virusi Varicella Zoster, i njëjti virus i cili është gjithashtu shkaktar i lisë së dhëve (variçela). Në Gjermani sëmurën çdo vit rreth 300 000 persona nga kjo sëmundje, me tendencë në rritje.

Herpesi prek vetëm ata persona, të cilët kanë pasur njëherë më parë një infeksion me linë e dhëve. Kontakti i parë në jetë me virusin Varicella-Zoster (VZV) çon në një sëmundje të lisë së dhëve, e cila në disa raste mund të përhapet edhe pa rënë në sy. Kur lija e dhëve shërohet, disa viruse mbesin në nyjat nervore (ganglia) të palcës kurrizore dhe trurit. Ato mund të zgjasin atje një jetë, pa shkaktuar simptoma të sëmundjes. Me rritjen e moshës, në veçanti te personat e moshës mbi 50 vjeç dhe te personat me sistem imunitar të dobësuar (edhe për shkak të ilaçeve), viruset mund të bëhen përsëri aktivë. Riaktivizimi i infeksionit VZV çon më pas në simptomat tipike të një herpesi në zonën e shtrirjes së nervave të prekur: Ndjesitë anormale, lëkura e skuqur, formimi i flluskave në një zonë të kufizuar, dhimbje kryesisht të forta. Trupi ose fytyra është më shpesh e prekur, zakonisht vetëm gjysma e trupit ose herpes vjen nga sulmi i nervave që dalin nga shtylla kurrizore dhe shtrihen në formë (gjysmë) rripi përreth trupit.

Vetë herpesi nuk transmetohet nga njeriu te njeriu, por megjithatë të sëmurët mund ta transmetojnë virusin te personat e ndjeshëm (jo imunë), p.sh. nga gjyshërit te nipërit, të cilët më pas sëmurën me linë e dhëve. Transmetimi mund të bëhet vetëm nga infektimi nga kontakti me përbajtjen e flluskave, jo përmes kollitjes dhe teshtitjes.

Herpesi shfaqet shpesh në moshë të vjetër. Në zonën e furnizimit të nervit të prekur, gjenden fillimisht flluska në lëkurë, të cilat më vonë thahen dhe krijojnë kore mbi të. Dhimbjet në zonën e nervit të prekur mund të vazhdojnë me vite (nevralgjia post zoster). Përveç komplikacioneve të mundshme siç janë paralizat ose infeksionet e tjera bakteriale në zonat e lëkurës të prekura nga Zosteri, në raste të rralla janë shfaqur edhe infeksione të palcës kurrizore, meningjtit ose inflamacione të trurit. Nëse preken nervat në fytyrë, atëherë mund të ndodhë inflamacion i syrit me përfshirje të retinës ose nervit optik, çrregullime të dëgjimit ose të ekuilibrit ose paralizë e muskujve të fytyrës. Në disa raste, Zosteri mund të shtrihet në zona nervore ngjitur, shumë rrallë edhe në të gjithë trupin (Zoster generalisatus).

Në fakt ka ilaçe që mund të përshpejtojnë shërimin e lëkurës, por megjithatë opsionet terapeutike për dhimbjet nervore të vazhdueshme janë të kufizuara. Vaksinimi kundër herpesit shërben për t'u mbrojtur kundër vetë sëmundjes së Zosterit dhe kundër shfaqjes së gjendjeve me dhimbje të vazhdueshme afatgjata (nevralgjia post herpetike, PHN).

Vaksina

Vaksina e inaktivizuar për Zoster prodhohet me anë të teknologjisë së ADN rikombinante. Ajo përmban një proteinë nga materiali gjenetik i patogjenit që është i rëndësishëm për përgjigjen imunitare dhe është i lidhur me një përbërës aktiv ndihmës (adjuvantët). Vaksina injektohet në muskul (injeksion intramuskular), mundësisht në krahun e sipërm. Vaksina kundër herpesit është e miratuar për personat e moshës 50 vjeç e lart.

Vaksina mund të bëhet njëkohësisht me vaksinën e inaktivizuar të gripit, vaksinën 23-valente për pneumokokun dhe me vaksinën e kombinuar kundër tetanozit, difterisë dhe kollës së mirë - në pjesë të veçanta të trupit (krahu i djathtë dhe i majtë). Megjithatë, nuk ka ende asnjë njohuri lidhur me administrimin e njëkohshëm me vaksina të tjera.

Kush duhet vaksinuar?

Komiteti i Përhershëm i Vaksinimit (STIKO) rekomandon vaksinimin

- si vaksinim standard për të gjithë personat mbi 60 vjeç
- si dhe për personat mbi 50 vjeç me rrezik shëndetësor të shtuar për shkak të një sëmundjeje bazë si p.sh.:
- pacientët me një çrregullim të sistemit imunitar, të trashëguar, të fituar ose për shkak të ilaçeve
- ata me infeksion HIV
- me artrit reumatoid ose Lupus erythematodes sistemik
- me sëmundje inflamatore kronike të zorrëve
- me sëmundje kronike të veshkave
- me sëmundje të mushkërive: COPD ose astmë
- me diabet.

Vaksina bëhet dy herë me interval të paktën 2 muaj, por më së voni pas 6 muajsh. Mbrojtja nga vaksinimi duhet të pritët rreth 4 javë pas dozës së 2-të. Për momentin nuk ka njohuri nëse pas disa vitesh është e nevojshme ndonjë dozë tjetër.

Kush nuk duhet vaksinuar?

Në rast të një sëmundjeje akute me temperaturë/ethe (mbi 38,5°C) që kërkon trajtim, vaksinimi duhet të shtyhet. Personat që janë alergjikë ndaj ndonjë përbërësi të vaksinës nuk duhet të vaksinohen. Për përjashtimet informoni mjekun tuaj.

Nuk ka njohuri lidhur me administrimin e vaksinës Zoster te gratë shtatzëna ose ato me fëmijë në gji, kështu që vaksinimi duhet të shmangët si masë paraprake (vaksina është e miratuar vetëm për moshën mbi 50 vjeç).

Vaksinimi nuk rekomandohet te personat, tek të cilët ka shpërthyer tashmë një sëmundje Zoster. Edhe trajtimi i një inflamacioni ekzistues të nervit Zoster nuk është i mundur me vaksinimin. Nëse nevojitet vaksinimi mund të bëhet më vonë. Mjeku juaj mund t'ju këshillojë për këtë.

Sjellja pas injeksionit të vaksinës

Personat e vaksinuar nuk kanë nevojë për ndonjë çlodhje të veçantë, por brenda 3 ditëve pas vaksinimit duhet të shmangët lodhja e rëndë fizike. Personat e prirur për alergji në sistemin e qarkullimit të gjakut ose me alergji të njohur të rënda duhet të informojnë paraprakisht mjekun përpara vaksinimit. Për shkak të shfaqjes së rasteve të pafuqisë vaksina duhet bërë shtrirë.

Reaksionet e përgjithshme dhe lokale të mundshme pas vaksinimit

Pas vaksinimit, përveç imunitetit të dëshiruar dhe në këtë mënyrë mbrojtjes ndaj sëmundjes te njerëzit e vaksinuar në vendin e vaksinimit, shumë shpesh (në ≥ 10 përqind të vaksinuarve) mund të krijohen skuqje të përkohshme ose ënjtje të dhimbshme dhe ngurtësim, si dhe ndjesi të ngrohtësisë. Kjo është një shprehje e konfliktit normal të trupit me vaksinën. Përveç kësaj mund të shfaqen kruajtje në vendin e vaksinimit (rreth 1 deri 10 për qind), herë pas here (0,1 deri 1 për qind) mund të shfaqen ënjtje në nyjet limfatike. Dhimbjet e muskujve dhe të kokës, lodhje, të dridhura dhe ethe, si dhe ankesa gastrointestinale (të përzierë dhe vjellje, dhimbje barku) përshkruhen shumë shpesh. Ethet dhe të dridhurat mund të ndodhin më shpesh nëse vaksina pneumokok 23-valente jepet në të njëjtën kohë. Me raste shfaqen dhimbjet e gjymtyrëve. Rastet e pafuqisë herë pas here ndodhin drejtpërdrejt pas (ose edhe më parë) vaksinimit si një reagim psikogjenik në futjen e gjilpërës, e cila mund të shoqërohet përkohësisht me shqetësime vizuale, ndjesi ose lëvizje të pavullnetshme gjatë fazës së rikuperimit (shiko gjithashtu te "Sjellja pas vaksinimit").

Si rregull, reagimet e përmendura janë të përkohshme dhe kalojnë shpejt dhe pa pasoja.

A janë të mundshme komplikacionet e vaksinimit?

Komplikacionet e vaksinimit janë pasoja shumë të rralla të vaksinimit që e tejkalojnë masën normale të një reaksioni vaksinimi, të cilat kanë një ndikim të rëndësishëm në gjendjen shëndetësore të personit të vaksinuar. Pas dhënies së vaksinës rikombinante të Zosterit, simptomat e lëkurës në lidhje me vaksinimin dhe reaksionet alergjike, përfshirë skuqjen ose urtikarian, janë vërejtur rrallë. Si me të gjitha vaksinimet e tjera, një reaksion alergjik i menjëhershëm, përfshirë shokun, nuk mund të përjashtohet pas administrimit të kësaj vaksine në raste të rralla individuale.

Këshilla mjekësore për efektet anësore të mundshme nga vaksinuesi

Për plotësimin e kësaj broshure mjeku juaj ju ofron një bisedë sqaruese.

Nëse simptomat shfaqen pas një vaksinimi që i tejkalon reagimet e shpejta të sipërpërmendura lokale dhe të përgjithshme kalimtare, atëherë vaksinuesi sigurisht që është i disponueshëm për këshilla.

Mund të arrini te vaksinuesi:

Deklarata e pëlqimit

Për vaksinimin mbrojtës kundër herpesit (Zoster) - me vaksinë të inaktivizuar

(Ekzistojnë gjithashtu formularë, sipas të drejtave të pacientit, për t'ua dhënë me vete pacientëve që bëjnë vaksinimin apo kujdestarëve të tyre.)

Emri i pacientit që vaksinohet _____

lindur më _____

Kam marrë parasysh përmbajtjen e fletëpalosjes dhe jam informuar, gjatë diskutimit, në detaje nga mjeku/mjekja ime për procesin e vaksinimit

- Nuk kam pyetje të tjera.
- Bie dakord për vaksinimin e propozuar ndaj herpesit – me vaksinë të inaktivizuar.
- E refuzoj vaksinimin. Jam informuar për disavantazhet e mundshme të refuzimit të kësaj vaksine.

Shënime: _____

Vendi, data: _____

Nënshkrimi i personit që vaksinohet.

Nënshkrimi i mjekut/mjekes

Mohim përgjegjësie

Versioni origjinal (06/2018) i fletëpalosjes është përkthyer me miratimin e Kryqit të Gjelbër Gjerman për Institutin Robert Koch. Teksti gjerman është mbizotëruar; për çdo gabim përkthimi dhe për përditësimin e përkthimit aktual, në rast të një përpunimi të mëvonshëm të versionit origjinal, i cili është në gjuhën gjermane, nuk pranohet asnjë përgjegjësi.

Emri

**Vaksinimi
ndaj herpesit
– me vaksinë të inaktivizuar**

Përpara kryerjes së vaksinimit kërkohen informacionet e mëposhtme shtesë:

1. A është personi që vaksinohet aktualisht i shëndetshëm?

Po Jo

2. A ka personi që vaksinohet ndonjë alergji?

Po Jo

nëse po, cila _____

3. A janë shfaqur te personi që vaksinohet shenja alergjike nga një vaksinim i mëparshëm, temperaturë e lartë ose reaksione të tjera të pazakonta?

Po Jo

Në rast se ju doni të dini më shumë rreth vaksinimit kundër herpesit, atëherë pyesni vaksinuesin!

Merrni me vete librezën e vaksinimit në datën e vaksinimit!